



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 6
12.01.2011

NR. VENDIMI 13
18.11.2011

**VENDIM
NE EMËR TË REPUBLIKËS**

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda e përbërë prej

**GJYQTAR: GURALI BRAHIMLLARI
GJYQTARE: NERTINA KOSOVA
GJYQTAR: IDRIZ MULKURTI**

Asistuar nga sekretare gjyqesore E. T. , mori në shqyrtim në disa seanca gjyqësore publike, në seancë të fundit, sot me datë 18.11.2011, ora 14.00, kërkesën që i përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda - Tiranë, përfaqësuar nga prokurori B. M.

KUNDËR: Të paditurit **A. H.** , i biri R. e N. , datelindjes xx.xx.xxxx, lindur në xxxx, xxxx, banues ne lagjen nr.xx, xxxxx, xxxxx, i **dënuar**. Mbrojtur nga avokati i zgjedhur V. M., Dhoma e Avokatisë Tiranë.

OBJEKTI: Konfiskimin e pasurive te meposhtme:
-Objekti Hotel –Restorant me x+x/x kate dhe siperfaqe ndertimi xxx mx për çdo kat, në gjendje pune, së bashku me të gjitha pajisjet dhe aksesoret e biznesit e ndertuar mbi truall me siperfaqe xxxmx, në zonën kadastrale nr. xxxx, në lagjen nr.xx, xxxxx, xxxxxx.
-Për ekzekutimin e ketij vendimi te ngarkohen Zyrat e Permbarimit Gjyqësor te Rrethit Dures, ndërsa per Administrimin dhe Perdorimin e pasurive te paluajtshme të

ngarkohet Z. V. P. ,
Administrator pranë Agjencise per Administrimin e Pasurive te
Sekuestruara dhe te Konfiskuara në Ministrinë e Financave
Xxxxx.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 10192 date 03.12.2009 “Per parandalimin dhe
Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet
Masave Parandaluese kunder Pasurise”.

PERSON I TRETET: (Ndërhyrës Kryesor) S. A. , i biri i J. e i L. , dt
xx.xx.xxxx, lindur ne xxxxxxxx, xxxx dhe banues në xxxxx, me
arsim të xxxxx, i xxxxxx më parë, me shtetësi xxxxxxx.
Mbrojtur ne gjykim nga avokate e zgjedhur F. A. , Dhoma e
Avokatise Xxxxx.

OBJEKTI : Kërkoj rrëzimin e kërkesës për konfiskimin si dhe heqjen e
sekuestros mbi atë pjesë të pasurisë të sekuestruara shtetasit
A. H. , të krijuar në sajë të investimit të kërkuarit (si
ndërhyrës kryesor).

BAZA LIGJORE: Neni 22 i ligjit nr. 10192 date 03.12.2009 “Per
Parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe
Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kundër Pasurise”.

Gjykata, pasi dëgjoi parashtrimin hyrës dhe kërkesat për prova të
Prokurorit dhe të mbrojtjes, mori në shqyrtimi provat e kërkuara prej tyre,
dëgjoi pretendimet përfundimtarëve të paleve në gjykim sipas të cilëve:

Prokurori B. M. kërkoi pranimin e kërkesës - Konfiskimin e pasurisë
objekt Bar-Restorant-Hotel me x+x/x kate dhe sipërfaqe totale ndërtimi xxxx
mx, në gjendje punë së bashku me të gjitha pajisjet dhe aksesoret e biznesit
ndodhur në lagjen nr.xx xxxxx , xxxxxx.

-Për admisnitrmin dhe perdorimin e kësaj pasurie te paluajtshme të
ngarkohet Z.G. L. , Administrator pranë Angjenisë për Administrimin e
Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, ndërsa për ekzekutimin e këtij
vendimi ngarkohen Zyra e Përmbarrimit e Rrethit Durrës.

Avokati V. M. përfundimisht kërkon: Rrëzimin e kërkesës për konfiskimin e objektit duke e konsideruar atë të padrejte dhe të kundraligjshme.

Personi i paditur në këtë gjykim, i denuari A. H. tha: Kërkoj përfundimisht nga gjykata te jepet drejtesi. Dua te shtoj që të merret parasysh nga Gjykata se ai biznes me të gjitha të ardhurat që kanë dale nga biznesi nga viti 2004 deri në momentin që është sekuestruar kërkoj nga Gjykata të njihen të ardhura të ligjshme.

Avokatja F. A. , mbrojtësja e personit te trete S. A. tha: Përfundimisht kërkoj: 1- Të mos pranohet kërkesa e Prokurorisë për Krime të Rënda për konfiskimin e objektit Bar-Restorant me x+x/x kate, me sipërfaqe totale ndërtimi xxxx mx, në gjendje pune së bashku me të gjitha pajisjet dhe aksesoret e biznesit. Të revokohet masa e sekuestros ndaj pasurie dhene me Vendimin nr.10,date 14.07.2010.

2- Njohjen pronare te xx% të gjithë ndertimit se bashku me pjesen e truallit mbi te cilin ngrihet te objektit Bar –Restorant-Hotel me x+x/x kate me siperfaqe totale ndertimi xxxx mx dhe Regjistrimin e kesaj pjese ne zyren e regjistrimit te pasurive te palujtshme.

Gjykata, si shqyrtoi këto pretendime, analizoi provat dhe vlerësoi çështjen në tërësi:

V Ë R E N s e

Nga shqyrtimi gjyqësor i akteve e provave të sjella nga palët në këtë gjykim rezulton e provuar se:

I padituri A. H. ka lindur në fshatin xxxxx, xxxxx dhe ka lidhje të afërt gjinie me Personin e Tretë, S. A. i cili është banorë i qytetit të xxxxx xxxx sepse ndodhet i regjistruar në Gjendjen Civile të këtij xxxxx. Ata janë xxx e xxxx. Rezultoi e provuar në gjykim se nëna e të paditurit A. , zj. N. H. është e motra e shtetasit S. H. , i cili provohet se ka ndryshuar, me Vendim të këshillit Bashkiak xxxx, xxxx emrin në **S. A.** për shkak të lehtësirave që ofronin autoritetet Greke, ku ai rezulton se ka qenë si emigrant për shumë vite që gjatë viteve xx' e në vijim.

I padituri A. është vendosur me banim në Lagjen nr xx xxxxx xxxxxx dhe se në vitin 2004 është martuar me dëshmitaren X. H. (B.). Ata kanë xxxxx xx xxxxx të cilët janë të xxxxx. Nuk u provua në gjykim që i padituri A. apo bashkëshorta e tij të kenë lidhur ndonjë kontratë punë apo të

kenë licencë për ndonjë aktivitet tregëtar. Ndonëse nga hetimi pasuria ka rezultuar se i padituri A. është zotëruesi i drejtpërdrejtë i pasurisë objket konfiskimi, ky objekt ka qënë rregjistruar si aktivitet tregëtar vetëm pjesërisht, fillimisht në emrin e vëllait të tij S. H., pastaj në ermin e kunatit, vëllait të bashkëshortes, shtetasit E. B. . Disa kohë përpara se pasuria të sekuestrohej ishte marrë nën administrim, me qera nga shtetasi M. M. .

Rezultoi e provuar në gjykim, se ndaj **të paditurit A. H.** dhe disa personave të tjerë, mbi bazën e akteve e provave të dërguar nga autoritetet gjyqësore të shtetit Italian, **në vitin 2007**, Prokurorisë për Krime të Rënda, **ka rregjistruar procedimin penal**, për të cilin rezulton se ka zhvilluar edhe vetë hetime dhe në përfundim e ka dërguar çështjen për gjykim.

Provohet se, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me **Vendimin nr. 10 datë 26.03.2010**, është vendosur midis të tjerave dhe **“Deklarimin fajtor të të pandehurit A. H.** për veprën penale të “Trafikimit të lëndëve narkotike » të kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë parashikuar nga **neni 283/a/2 i Kodit Penal** duke e dënuar atë përfundimisht me 10 vjet e 8 muaj burgim. Nga aktet e hetimit dhe gjykimin të procedimit penal rezulton se i gjykuari A. H. në bashkëpunim me persona të tjerë, që nga data 12.01.2003 e në vijim ka qënë i përfshirë në veprimtarinë kriminale për të cilën është gjendur fajtor. Sipas bisedave telefonike të zhvilluara dhe arsyetimit në tërësi të Vendimit Gjyqësor të sipërcituar, i gjykuari A. ka qënë bashkëpunëtor në kryerjen e veprës penale të « Trafikimit të narkotikëve në disa prej episodeve kriminale.

Provohet gjithashtu se Prokuroria për Krime të Rënda, në **datën 25.06.2010**, ka urdhëruar **regjistrimin e procedimit pasuror, që rrjedh nga procedimi penal nr 659, të vitit 2010 ardhur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tirane, për shtetasin nën hetim A. R. H. si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar si krim nga neni 283/a/2 i K.penal.**

Pas kryerjes së veprimeve verifikuese, në përputhje me ligjin parandalues, provohet në gjykim se në **datën 12.07.2010**, në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka ardhur për shqyrtim kërkesa e Prokurorisë për Krime të Rënda me objekt sekuestrimin e pasurive të gjendura nën posedim apo pronësi të të dënuarit/paditurit A. H. .

Provohet gjithashtu se me **Vendimin nr 10 datë 14.07.2010**, Gjykata ka disponuar në favor të kërkesës së Prokurorisë për Krime të Rënda duke

Vendosur: Sekuestrimin e pasurisë të njohur si objekti ““Bar-Restorant-Hotel, “xxxx”, i përbërë nga me x+x/x kate dhe sipërfaqe ndërtimi xxx mx për cdo kat, aktualisht në gjendje pune sipas emërimit të tij. Sekuestrimi i objektit urdhërohet të bëhet me të gjitha pajisjet dhe aksesorët e nevojshëm për ushtrimin e aktivitetit tregëtar. Kjo pasuri që sekuestrohet gjendet e ndërtuar mbi truall me sipërfaqe xxxmx në zonën kadastrale nr. xxxx, në lagjen nr.xx, xxxx, xxxxx...”.

Ky vendim ka marrë formë të prerë sepse Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me vendimin nr 31 datë 30.09.2010 ka vendosur: “Lënien në fuqi të Vendimit nr 10 datë 14.07.2010 të Gjykatës së Shkallës Së parë për Krime të Rënda.”

Në bazë të akteve të sjella për gjykim, rezulton se pasuria e mësipërme përpara dhënies së vendimeve të sipërcituara, ka qënë në funksionim të plotë si xxxx-xxxxxxx dhe xxxx dhe se, me pëlqimin e të paditurit A. e të afërmeve të tij, i është dhënë nën administrim me xxxxxx xxxxxx, shtetasit kosovar M. M. .

Në ekzekutim të vendimit të sekuestrimit, është mbajtur proces verbal nga P. C. , përmbarues i zyrës Përmbarimore Durrës, sipas të cilit rezulton se **pasuria** e urdhëruar për sekuestrim **është sekuestruar dhe është bërë inventari** përkatës duke përfshirë edhe aksesorët dhe pasuritë e luajtëshme. Të gjitha këto i janë **dorëzuar në administrim z. I. C. ,** administrator i Agjencisë të administrimit të Pasurive të Sekuestruara e Konfiskuara. Ky proces verbal është shoqëruar me fotografitë përkatëse dhe provohet se është mbajtur në prezencë të bashkëshortes së të paditurit A. H. , zj X. H. si dhe të shtetasit kosovar M. M. .

Prokuroria Për Krime të Rënda ka vijuar verifikimet pasurore për të paditurin A. H. në datën **12.01.2011**, ka paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, kërkesën me objekt **Konfiskimin e pasurive të cilat ishin sekuestruar sipas vendimit të sipërcituar.** Në bazë të provave të paraqitura nga palët në këtë gjykim, provohet se **para, gjatë e pas periudhës që i dyshuari A. H. ka qënë i përfshirë** në veprimtarinë kriminale në fushën e trafikimit të narkotikëve ai **ka kryer investime** në drejtim të pasurive të paluajtëshme si vijon:

Rezulton se në emër të z. Q. P. kanë qënë të regjistruara me zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtëshme Durrës, disa ngastra trualli me sipërfaqje respektivisht xxxmx; xxx mx; xxmx; dhe xx mx, të gjitha në afërsi me njëra tjetrën e që ndodhen në zonën kadastrale nr. 8518, Plazh/13, Durrës.

Provohet në gjykim se, me kontratën nr. xxxx rep. xxxx kol. **datë 02.09.2002**, i padituri **A. H. ka blerë** nga shitësi Q. P. , ngastrat e mësipërme, me **një sipërfaqe totale truall prej xxx mx** ndodhur në zonën kadastrale nr. xxxx, në lagjen nr. xx Plazh, Durrës. Sipas deklaramentit të palëve para noterit, kjo pasuri është blerë për shumën **prej 900 000(nëntëqin mijë) lekë**. Për këtë pasuri shitësi Q. kishte marrë më parë një leje ndërtimi dhënë nga Bashkia Durrës **me Vendimin nr. 10 datë 02.08.2002** sipas të cilit ai lejohet të ndërtojë mbi këtë truall **një banesë me tre kate**. Provohet se kjo leje ndërtimi është bërë funksionale, **vetëm në datën 15.01.2003**, kur është zbardhur e është lëshuar **në favor të ish pronarit të truallit**.

Provohet se **i padituri A. H.** këtë sipërfaqje trualli e ka regjistruar **në datën 24.10.2002**.

I padituri A. H. , rezulton se **në datën 13.01.2003**, me **cilësinë e investitorit**, si pronar i truallit ka lidhur një **kontratë sipërmarrje** nr xx/rep dhe nr xx Kol, për ndërtimin e objektit "Banesë tre kate" me shoqërinë e ndërtimit "xxxx", sh.p.k. Sipas kësaj kontrate rezulton se investitori A. H. , duhet të paguante në favor të firmës ndërtuese, **vlerën prej 160 USD/ mx** dhe meqënëse

sipërfaqja ndërtimore në lejen e ndërtimit ishte xxxx mx, vlera totale e kontratës është përcaktuar mes palëve **në shumën 192 960 USD**.

Ndërtimi i objektit sipas kërkesës për konfiskim, provohet se **ka filluar në datën 29.01.2003**. Rezulton se firma ndërtuese "xxxx" Sh.p.k. që para se të fillonte ndërtimin e objektit, **në datën 29.01.2003**, është paraqitur dhe ka depozituar në Policinë Ndërtimore në Durrës **"njoftimin për fillimin e punimeve si dhe dokumentacionin për objektin x(xxx) kate, protokolluar me numër 95/1 në këtë institucion"**.

Nuk u paraqitën prova për mënyrën e likuidimit të firmës ndërtuese dhe pala e paditur pretendon se e ka likuiduar atë në "cash"(drejtpërdrejtë në dorë), jo nëpërmjet bankës, ndonëse vlera monetare është e konsiderueshme.

U provua në gjykim se **ndërtimi i këtij objekti, nga banesë xxx xxxx sipas lejës së ndërtimit, është përshtatur për aktivitet tregëtar**.

I padituri A. H. , pasi e ka përfunduar, duke ndërtuar sipërfaqje ndërtimore më të madhe se sa leja e ndërtimit, e ka paisur me sendet e nevojshme të luajtëshme për funksionimin si "Bar-Restorant-Hotel" përfshirë edhe paisjen e xx dhomave për fjetje. Ai ka filluar të shfrytëzojë këtë pasuri, në verë të vitit 2004 sepse u provua se është licensuar nga organet tatimore nën

emrin e të vëllait, S. H. , për të ushtruar aktivitetin si “Biznes i vogël” dhe se për atë vit ka deklaruar xhiro vjetore prej 7 500 000(shtatëmilion e pesëqindmijë) lekë. Më pas, rezulton se i padituri A. H. ka marrë një lejë tjetër në emrin e tij duke rikonstruktuar më tej ndërtesën si dhe duke legalizuar ndryshimin e destinacionit që ai e kishte bërë. Provohet në gjykim se nga Komuna Rrashbull është dhënë **leja e ndertimit nr. 05 datë 06.10.2005**, sipas së cilës i padituri A. është lejuar të ndërtojë edhe xx kate shtesë mbi këtë objekt. Në këtë leje ndërtimi është përshkruar se destinacioni i ndërtesës ndryshon nga godine banimi, në lokal +hotel. Aty është saktësuar se pasuria e të paditurit A. H. mbi këtë tokë truall do të jetë ndërtesë pese kate, me përbërje “ **Një kat(katin e parë) Lokal dhe katër kate Hotel**”(pra gjithsej 5 kate).

Rezulton se ndërtimi i ri, nuk është realizuar më me firmën e ndërtimit “xxxx” sh.p.k., por me firma të ndryshme dhe se është vënë në shfrytëzim i kompletuar si “Bar-restorant –Hotel”. Nuk provohet nga pala e paditur as firmat e kontraktuara prej tij, as mënyra e pagesës së këtyre firmave që kanë kryer punimet dhe as vlera e paguar atyre.

Në vijim, në bazë të provave të marra në shqyrtim në seancë gjyqësore ka rezultuar se që në fazën e hteimit pasuror është evidentuar se i padituri A. H. , ka realizuar edhe një tjetër ndërtim shtesë, për të cilin nuk rezulton se ka marrë leje ndërtimi dhe që ka përfshirë **shtesë kati, papafingo; ndërsa gjatë gjykimit u verifikua se ai ka ndërtuar edhe shtesë anësore**. Aktualisht i gjithë objekti funksionon si një i tërë me gjithë ndryshimet e shtesat e bëra sepse, siç provohet edhe nga akti i ekspertimit vlerësues, këto ndërtime janë përshtatur në funksion të të gjithë objektit si “Bar-Restorant- Hotel”. Ky objekt në momentin e sekuestrimit është quajtur “xxxx”, ndërsa aktualisht gjendet me emërtimin “xxxxxxxx”.

Faktet si më sipër u evidentuan gjatë gjykimit të kësaj çështjeje, si mbi bazën e provave shkresore të paraqitura nga akuza dhe nga mbrojtja, nga pretendimet e pohimet e tyre, nga provat me dëshmitarë e posacërisht gjatë kryerjes së një akti ekspertimi vlerësues e kontabël.

Kështu, në zbatim të detyrave të lëna nga kjo gjykatë, mbi bazën e kërkesave të palëve, gjatë verifikimeve në objekt nga eksperti vlerësues S. K. dhe përfundimeve të tij në aktin e ekspertimit, rezulton se i padituri A. H. ka kryer investim në një sipërfaqje ndërtimore shumë më të madhe se sa ajo që ka marrë leje ndertimi. Sipas **aktit të ekspertimit vlerësues**,

paraqitur e debatuar në disa seanca gjyqësore, **provohet se sipërfaqja ndërtimore faktike** në pasurinë objekt konfiskimi përfshin gjithësej jo $x + x/x$, por **7 kate të ndërtuara**, me specifikat si vijon:

-Një kat bodrum (kati -x)- ambient shërbimi me sip. xxx mx;

-Kati përdhes- ambient shërbimi, restorant e ambient ndihmës me sipërfaqe xxx mx

-Katër kate, janë ambiente hotele me sipërfaqje ndërtimore secili kat xxx mx(gjithsej xxxxx mx)

-Kati papafingo, aktualisht karabina me sipërfaqje xxx mx.

Pra, nga akti i ekspertimit rezulton se nga ana e të paditurit **A. H. është investuar për ndërtimin në total të një sipërfaqje ndërtimore prej xxxx mx, të shtrirë në shtatë kate ndërtesë.**

Nga kryerja e ekspertimit vlerësues rezulton se në tërësi në këtë objekt, **vetëm për ndërtimin e sipërfaqes ndërtimore prej xxxx mx**, që është ndërtuar faktikisht, është investuar gjithsej shuma monetare **prej 61 893 406.2 lekë** (shih aktin e ekspertimit vlerësues të ekspertit S. K. faqe 19).

Rezulton gjithashtu se i padituri A. H. ka investuar edhe për ta vënë në shfrytëzim duke e paisur tërësisht, me përjashtim të sipërfaqjes që zë xxxxxxxxx, gjithë mjediset e tjera, me sendet e nevojshme për funksionimin e objektit si një i tërë për aktivitetin tregëtar “Bar-Restorant-Hotel”. Për të llogaritur vlerën e investuar në pasurinë e luajtëshme, Gjykata kërkoi nga eksperti që t’i referohej vlerës së sendeve që janë gjendur në objekt në momentin e sekuestrimit të kësaj pasurie kur sic u tha është bërë inventarizimi i plotë i sendeve të gjendura.

Kësaj shume duhet t’i shtohet edhe **vlera e aksesorëve dhe e paisjeve që ka investuar** i padituri A. H. për vënien në funksion të pasurisë objekt konfiskimi e cila është llogaritur në shumën **8 491 400(tetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind) lekë.**

Në total **vlera e investimit** e përballuar **nga i padituri A. H. është në shumën 70 384 806.20 lekë** (Shtatëdhjetë milion e treqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e gjashtë) lekë e 20 qindarka

Vlera reale e kësaj pasurie aktualisht, është shumë më e madhe, vlerë të cilën eksperti vlerësues e ka llogaritur sipas koeficientëve përkatës pasqyruar në aktin e ekspertimit. Sipas ekspertimit vlerësues rezulton se aktualisht vlera në tregun e lirë të kompleksit turistik “xxxxxx ” (kështu quhet sot) është **1 100 000(njëmilion e njëqind mijë) euro** (shih faqen 24 te aktit të ekspertimit).

Ndërsa vlera aktuale, e sipërfaqes së tokës prej xxx mx është **144 000**

(njëqind e dyzet e katërmijë) euro ose 240 euro/m2.

Gjykata sqaron se vlerësimi real i pasurisë merr rëndësi vetëm në rastet e shqyrtimit të kërkesës për përcaktimin e raporteve të bashkëpronësisë, pra të raporteve midis **pronësisë së ligjshme dhe pasurisë që duhet të konfiskohet e të kalojë në favor të shtetit**. Në kushtet kur, ndonëse sipërfaqja e truallit në të cilën është ndërtuar objekti “Bar-Restornat-Hotel”, nuk është sekuestruar më parë dhe në mënyrë të tërthortë pala paditëse e ka njohur si pronë të ligjshme të të paditurit A. H. dhe nuk e ka përfshirë në objektin e kërkesës për konfiskim, duhet të ishte parashtruar edhe pretendimi për përcaktimin e raporteve të bashkëpronësisë. Në kushtet kur nuk u paraqit nga palët një pretendim i tillë, Gjykata, bazuar në nenin 28 të K.PrCivile, vetëm e evidenton si fakt dhe e konstaton, por nuk disponon për këtë raport, duke mos dalë jashtë objektit të padisë e e kërkitimit në të .

Gjykata sqaron gjithashtu se, i padituri A. H. , nuk do të ketë asnjë detyrim për të justifikuar vlerën reale të pronës objekt konfiskimi, por ai ka barrën e provës të vërtetojë në gjykimin parandalues, vlerën e investimeve të kryera prej tij në krijimin e kësaj prone. Meqënëse në pretendimet e tij ai pohon se në këtë pasuri ka investuar edhe daja i tij, **ndërhyrësi kryesor S. A. ,** pretendimet e secilit prej tyre për ligjshmëri e këtij investimit, në bazë të nenit **21/3 e ligjit 10192 datë 03.12.2009**, duhet të provohen prej tyre me **prova** sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj si dhe në Kodin e Procedurës Civile.

Mbi bazën e provave të marra në gjykim, Prokuroria për Krime të Rënda, pretendon se nga pasuritë e luajtëshme e të paluajtëshme që janë gjendur në posedim të drejtpërdrejtë apo në pronësi të të paditurit A. H. , duke përjashtuar vetëm sipërfaqjen e truallit mbi të cilën është ndërtuar objekti, përfshihen nën efektin e ligjit parandalues.

Akuza pretendon se i gjithë ndërtimi i kryer mbi këtë sipërfaqje trualli duhet të konfiskohet sepse është krijuar prej të Paditurit A. H. , pas periudhës kur rezulton se ka qënë i përfshirë në aktivitetin e paligjshëm të “Trafikimit të narkotikëve”, për të cilin edhe është hetuar, gjykuar dhe është gjetur fajtor nga Gjykata e Shkallës së Parë dhe nga Gjykata e Apelit Për Krime të Rënda Tirane. Meqënëse nga hetimet e gjykimi penal i zhvilluar, ka rezultuar se nga ana e shtetasit A. H. , në bashkëpunim me shtetas të tjerë, janë trafikuar nga Shqipëria në Itali sasi të mëdha lënde narkotike të llojit “heroinë”, sasi e cila është kapur dhe sekuestruar nga autoritetet italiane, ai jo vetëm që është i dyshuar, por për më tepër është i dënuar, me vendim gjyqësor

të formës së prerë për një nga veprat penale të parashikuara në nenin 3/1 të ligjit 10 192 datë 03.12.2009, prandaj **i padituri A. H. është subjekt i ligjit parandalues dhe ka detyrimin e barrën e provës sipas ligjit parandalues që të justifikojë ligjshmërinë e kësaj pasurie.**

Pala e paditur A. H. e mbrojtja e tij, pretendoi se pasuria objekt konfiskimi është vënë me punë të ligjshme, se dënimi i të paditurit A. është rrjedhojë e gabimeve të Prokurorisë sepse ai nuk është marrë me veprimtari kriminale për të cilën është dënuar, se subjekt i ligjit po bëhen edhe pjesëtarë të familjes së tij që nuk kanë kryer ndonjë krim. Gjithashtu mbrojtja dhe i padituri pretendojnë se “Pasuria nuk është e rregjistruar” prandaj nuk mund të përfshihet në rrethin e pasurive ku mund të veprojë ligji parandalues. Kjo pasuri nuk duhet të konfiskohet sepse sipas nenit 193 të K.Civil nuk është bërë pjesë e qarkullimit civil.

Ndryshe nga sa pretendon akuza, mbrojtja dhe i padituri pretendojnë se **pasuria ka filluar të krijohet dhe pjesa më e madhe e tij është ndërtuar, përpara** periudhës kur akuza pretendon se A. është përfshirë në aktivitetin e trafikimit të lëndëve narkotike. Sipas tyre, godina filloi të ndërtohet **në Gusht 2002** dhe i gjithë Hoteli **ka përfunduar në Mars 2004**, se për të janë investuar paratë e marra hua nga puna e tij në emigracion, nga puna e të afërmve të tij, si nga nëna, motra e tij si dhe nga daja S. A. , i cili ndërhyri si palë e tretë në këtë gjykim.

Pala e paditur pretendon se në investimin e kryer pas marrjes së lejes së ndërtimit në Tetor të vitit 2005 si dhe shtesa e papafingos e shtesa anësore, janë përballuar nga fitimet e realizuar prej punës dhe aktivitetit tregëtar në Bar-Restornat-Hotel “xxxx”, pra në vetë këtë objekt që sipas saj është shfrytëzuar plotësisht që në vitin 2004 e në vijim dhe se ka pasur aktivitet shumë fitimprurës e të deklaruar në organet tatimore në certifikatën e biznesit të vogël nën emrin e të afërmve të tij, vëllait S. H. e më vonë të të kumatit, K. B. .

Në këtë gjykim, siç u tha, bazuar në nenin 22/3 të ligjit 10192 datë 03.12.2009, si dhe në nenin 189 të K.Pr.Civile, **Gjykata vendosi të legjitimojë si Palë e Tretë**, ndërhyrës kryesor në këtë proces, shtetasin **S. A. , i cili u përfaqësua nga avokate F. A. .** Në seancën gjyqësore të datës 24.05.2011 u paraqit personalisht Personi i Tretë S. A. dhe prej tij si dhe prej mbrojtëses së zgjedhur prej tij u dhanë shpjegime lidhur me pretendimet e tyre për pasurinë objekt konfiskimi.

Rezulton se **Pala e Tretë S. A.** , pretendon se ka interesa të drejtpërdrejta mbi pasurinë objekt konfiskimi sepse ka **investuar rreth xx %** të të gjitha shpenzimeve që janë kryer për ndërtimin e tij nga hapja e gropës për ndërtim e deri në vënin e tij **në funksionim në vitin 2004.**

Mbështetur në nenin 21/3 të ligjit 10 192 datë 03.12.2009, dhe frymës së përgjithëshme të ligjit parandalues, Gjykata lejoi palën e paditur dhe Personin e Tretë që të paraqisnin prova lidhur me çka pretenduan për justifikimin e ligjëshmerisë së pasurisë’ Sipas kësaj dispozite **”Barra e provës për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjëshme, i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi”**

Në përmbushje të këtij detyrimi, i apdituri paraqiti deokumente bankare në emër të nënës së tij dhe të motrës, sipas të cilave ato kishin pasur të depozituara së bashku rreth 15 000 000, shumë të cilën e kanë tërhequr dhe ja kanë dhënë për investym në këtë objekt.

Po kështu paraqiti kontrata huaje mes vjeres së tij e bashkëshortes ku pretendonte se kishte marra prej saj shumen prej 5 000 000 lek lek dhe e kishte investuar në objektin Bar Restornt Hotel. Ai pretendoi gjithastu se kishte investuar në këtë objekt edhe vlerën rreth 220 000 USD nga daja i tij, S. A. , me të cilin pas pamundësisë për tja kthyer si hua, kishte pranuar vlerën prej xx% të objektit. Për të provuar këtë pretendim ai kërkoi që S. A. të thirret si palë në këtë gjykim dhe paraqiti kontratën e huasë të datës **31.12.2006.**

Personi i Tretë S. A. , i paraqitur personalisht para gjykates dhe më pas nepërmjet mbrojtëses së tij, pretendon se me kontratën e datës 31.12.2006, sipas së cilës i padituri A. , kur ende nuk ishte i arrestuar në procesin penal, ka pranuar se ka marrë hua shumë e investuar në këtë objekt në vlerën e 220 000 dollarëve dhe se meqënëse ai nuk ka patur mundësi ta kthejë këtë shumë, me deklaratë noteriale para noterit, ka shprehur vullnetin e tij se duhet ta njohë bashkëpronar në këtë pasuri. Mbrojtja e Personit të Tretë, pretendon se në kushtet e ndërhyrjes së shtetit mbi këtë pasuri sipas ligjit parandalues, kjo vlerë e investuar prej Personit të Tretë, nuk duhet të konfiskohet, por t’ i kthehet atij si pronar i ligjshëm i pjesës në para që ka investuar.

Lidhur me **rrethanat e përfshirjes** së tij në këtë investim, dhe për **masën** e kontributit, **Pala e Tretë pretendon se pas blerjes së xxxxxx** nga vetë i padituri A. i ka kërkuar ndihmë për ngritjen e objektit dhe se ai nisur nga raportet e marrëdhëniet e veçanta me të, fillimisht i ka dhënë hua dhe deri në

përfundimin e ndërtimit e vënien në funksionim në Xxxxx xxxx. Po kështu ai pretendon se ka pranuar që nga fitimet që janë realizuar nga aktiviteti i xxxxx, i padituri A. të investonte për ndërtimin e shteses sipas lejës së ndërtimit nr 5 datë 06.10.2005. Në total sipas tij rezulton se **investues në rreth xx%** të shpenzimeve të kryera është S. A. . Pra ai pretendon se nuk ka marrë pjesë në investim vetëm në momentin e blerjes së truallit në Gusht 2002 si dhe në realizimin e shtesës anësore të ndërtuar në Gusht –Shtator 2008, vlerën e të cilave, sipas tij, e ka përballuar i Padituri A. H. .

Pala e Tretë pretendon se, nisur nga marrëdhëniet e afërta të gjinisë me të Paditurin A. H. ,(të cilin e ka nip, djalin e motrës), ai nuk ka lidhur me të, që në fillim kontratë me shkrim. Meqënëse më pas, mes tyre pati kontradikta u detyrua që në 31.12.2006 të lidhte kontratën e huasë Nr xxxx/rep dhe xxx Kol. Pala e Tretë pretendon se vlerën e parave të investuara në këtë objekt, pra shumën prej 220 000 dollarë e ka fituar në mënyrë të ligjshme, nga xxxx e tij dhe e bashkëshortes së tij si emigrante në Greqi, për vërtetimin e së cilës do të paraqiste provat shkresore.

Gjykata, si dëgjoi palët në parashtrimin e pretendimeve të tyre dhe kërkesat për prova, në seancën gjyqësore të datës 22.02.2011, në bazë të nenve 12 e 213 të K.Pr.Civile, vendosi të pranojë për shqyrtim provat e paraqitura nga palët(shih procesverbalin e seancës). Njëkohësisht Gjykata rrëzoi kërkesën e mbrojtjes për të paraqitur në mënyrë të drejtpërdrejtë disa **deklarata noteriale të lëshuar nga persona** që ajo i ka thirrur edhe si dëshmitarë në këtë proces.

Debati gjyqësor filloi me shqyrtimin e provave shkresore të fashikullit të gjykimit të paraqitura nga akuza, për të cilat, në tërësi mbrojtja nuk kishte kundërshtime dhe kërkoi që të bëheshin pjesë e fashikullit të gjykimit duke sqaruar se për vlefshmërinë e këtyre provave mbrojtja do të shprehet në konkluzionet përfundimtare.

Në disa seanca gjyqësore mbrojtja e të pandehurit A. H. , paraqiti për shqyrtim provat me dëshmitarë e provat shkresore.

Kështu në seancë gjyqësore u pyeten dëshmitarët X. H. , K. Ll. , K. B. të cilët në dëshmitë e tyre para gjykatës pretenduan se kanë pasur marrëdhënie të veçanta me të paditurin A. , pasi kanë lidhje gjinie me të dhe se i kanë dhënë atij shuma të konsiderueshme parash me qëllim ndërtimin e objektit në konfiskim.

Kështu dëshmitarja X. H. , bashkëshorte e të paditurit prej 2004 ndërsa deklaroi se kanë bashkëjetuar nga viti 2001. Dëshmitarja ka deklaruar se

i padituri, bashkëshorti i saj qenë në shtetin italian me dokumenta të rregullta dhe është marrë me “tregëti makinash”. Ajo ka deklaruar mbi vendin ku ka filluar të ndërtohet objekti në vitin 2001, toka pronë e shtetasit Q. P. dhe pas blerjes së tokës, në vlerën rreth 9 milion leke të reja e likuidimi është bërë në momentin e blerjes së tokës, i ka kaluar dhe leja e ndërtimit e marrë nga pronari i saj e më pas me ndërtimin e objektit me të cilat është marrë i padituri A. . Dëshmitarja deklaroi se A. ka marrë para hua te daja i tij dhe ajo te mamaja e saj, por ndërkohë që te nëna e saj deklaroi se ka marrë 5 milion lekë të reja në vitin 2006, nga biznesi i nënës së saj dhe me akt **noterial në vitin 2010**. Por ajo nuk përcakton as kohën se kur i padituri A. të ketë marrë tedaja i tij para hua. Ajo ka deklaruar se në vitin 2006 kanë ndërtuar shtesën prej x kate, ndërsa godina prej tre kate nga 2004 ka filluar të shfrytëzohej si hotel. Dëshmitarja ka deklaruar se në vitin 2002 i padituri i ka marrë borxh nënës së tij dhe të motrës një sasi në total prej 150 milion lekësh si dhe personave të tjerë në sasi të caktuara prej 30 apo 25 milion lekësh pa i përcaktuar në kohë, sikundër përmend se shifra e investuar nga daja i të paditurit di të jetë prej 220 mijë dollarë. Dëshmitarja shprehet se vlera e tokës ka qenë 9 milion lekë të vjetra e jo të reja dhe në vitet 2001-2003 ka filluar e vazhduar ndërtimi i objektit. Dëshmitarja nga njëra anë deklaroi se në vitin 2004 ka filluar funksionimi i objektit e “pastaj A. është marrë vesh me dajen e vet për të vazhduar ndërtimin” nga ana tjetër deklaroi se ka qenë viti 2002 pa i përcaktuar datat dhe vitet apo mënyrën e dhënies së lekeve nga daja tek i padituri por ajo di se me dokument janë bërë në vitin 2006. Dëshmitarja ka deklaruar edhe mbi shitjen e një banese prej nënës së saj për të dhënë dëshmitares lekë hua e ndërkohë kanë qëndruar në banesë me qera dhe mbi blerjen e banesës së dytë nga nëna e saj.

Dëshmitarja K. Ll. e motra e të paditurit A. H. deklaroi se ka qenë emigrante në Greqi nga viti 1996 deri në vitin 2004, kohë kur kujton se është kthyer në Shqipëri dhe ka filluar të punojë në hotelin e përfunduar të të vëllait A. . Ajo deklaroi se se i vëllai A. nga fundi i vitit 2002 ose 2003 i ka kërkuar 50 milion lekë dhe ajo i ka tërhequr nga Banka BKT(depozituar nga 2001) e ia ka dhënë me përqindje. Këto A. ia kërkuar për të për të ndërtuar hotelin e nuk ia ka kthyer. Dëshmitarja ka deklaruar se të ardhurat për të depozituar në Shqipëri i sillnin pjesë pjesë nga Greqia me persona të ndryshëm dhe ajo i ka patur edhe në emër të nënës së saj e kur i janë dashur të paditurit A. kjo sasi lekesh, i ka tërhequr nga banka nëna e saj. Nga viti 2003-2008 i padituri A. i

ka dhënë si përqindje në muaj 500 mijë lekësh në muaj por këtë veprim nuk e kanë bërë me dokument mes vëlla e motër as për shumën prej 50 milion lekësh të vjetra.

Dëshmitarja K. B. e cila deklaron se në kohën që i padituri Alket po ndërtonte i duheshin lekë dhe se në vitin 2006, meqënëse kishte lekë gjendje sepse kishte shitur shtëpinë, i kishte dhënë A. , për një afat prej 10 vjetësh, 50 milion lekë të vjetra. Këto lekë që i kishte në Bankë, tek BKT Durrës, ia kishte dhënë A. dhe të bijës por me të drejtë kthimi, pa interes.

Dëshmitarja ka deklaruar se i biri E. pas vitit 2005 ka punuar te A. si menaxher. Dëshmitarja ka deklaruar për shtëpinë e shitur dhe se dhe i ka dhënë të paditurit A. sasinë e deklaruar prej 50 milion lekësh të vjetra.

Ndërsa dëshmitari K. Q. , deklaron se e ka njohur të paditurin A. nga viti 2002, pasi kanë patur pranë parcelat e tokës. Dëshmitari pretendon se i ka dhënë hua të paditurit një shumë prej 20 milion lekësh me përqindje interesi, pasi i padituri ia ka kërkuar hua ngaqë i kishin bllokuar punimet policia tatimore. Këto para dëshmitari deklaron se i ka përfituar nga shitja e një toke me sipërfaqe 500 metra në vitin 1998. Dëshmitari ka deklaruar se i padituri i ka dhënë interesin rregullisht(në një vlerë prej 300 000 (treqind mijë) lek te vjetra në muaj nga viti 2002 deri në Gusht 2008) por jo sasinë primare të lekëve, ndërkohë që dhënien e kësaj sasi të pretenduar deklaron se ia ka dhënë pa ndonjë dokument ligjor por vetem pasi i padituri A. është arrestuar ata kanë nënshkruar një kontratë.

Dëshmitari N. Z. ka deklaruar se ka një firmë sipërmarrëse ndërtimi bashkë me vëllezërit e tij. Nga viti 2001 ka ardhur në Durrës e deri në vitin 2006 ka punuar pa licensë dhe ka ndërtuar 5 pallate në Golem apo dhe në objektë të tjera duke përmendur dhe objektin ”xxxx” kur ka bërë shtesën e pallatit(kështu e quan dëshmitari) të pjesës papafingo, shtesën anësore prej 50 metra katrorë dhe shtesën e katit lart nga maji –gusht të vitit 2008. Ai ka deklaruar se është paguar 5 milion lekë të vjetra dhe i ka për ti marrë të paditurit A. një sasi prej 20 milion lekë të vjetra, por që për shkak të arrestimit të tij i ngelën pa iu marrë. Ka punuar në objekt 4-5 muaj dhe vlera e likuidimit përfshinte koston e punës dhe armatimeve. Në nëntor të 2009 dëshmitari deklaron se kanë bërë dokument mbi këtë sasi lekësh. Dëshmitari nuk i ka raportuar punimet me situacion apo dokumente pranë zyrës tatimore dhe gjithashtu ai nuk disponon asnjë dokument se ka kryer punime në objektin e quajtur “xxxx”.

Edhe shtetasi S. A. , i thirrur fillimisht si dëshmitar nga Pala Padiëse, u paraqit personalisht në seancë gjyqësore duke deklaruar se ka ndryshuar në gjendjen civile emrin nga S. H. në këtë të fundit në vitet 1996 dhe 2000. Lidhja me të paditurin A. qëndron në të qëniti dajë e nip. Ai ka deklaruar se në vitin 2002 kanë filluar një aktivitet për ngritjen e një objekti, mbi një tokë të blerë nga Gushti i vitit 2002 ose Shtator, që sot ky objekt ekziston si hotel ne Durrës, tek Shkëmbi i Kavajës, duke iu referuar objektit për të cilin kërkohet konfiskimi. Ai ka punuar në Greqi nga viti 1993 dhe ka dashur të hapë një biznes në Shqipëri dhe ka rënë menjëherë dakort me të paditurin e pasi ka parë letrat dhe lejen e ndërtimit është bindur të bashkëpunojë me të paditurin A. . Mirëpo kjo ka ndodhur, sipas deklaramit të kur tij Policia e Nderimit A i kishte pezulluar punën, sepse për ndërtimin e objektit kërkohet një firmë e rregullt ndërtimi për marrjen përsipër të ndërtimit dhe kanë gjetur firmën “xxxxx” nga Ura Vajguore duke rënë dakort në 13 Janar të vitit 2003, **duke i dhënë 40 mijë dollare** shtetasi S. **ndërsa 33 mijë dollare i padituri A.** .Vlera e punimeve u deklarua se ishte në masën xxx mijë xxxxx dhe do ti shlyhej **cdo dy muaj nga 40 mijë dollare** por nuk dokumentohet në asnjë akt noterial apo bankar pasi veprimet sipas deklaramive të tij në seancë janë kryer “cash”. Paratë ai deklaroi se ia ka dhënë të gjitha nga periudha **Janar deri në Qershor të vitit 2003** e se personalisht shuma që i ka dhënë **deri në Qershor 2003 ishte 160 mijë dollar**, ndërsa A. kishte dhënë 33 mijë dollare. Pas kontratës me firmën “xxxxx” objekti ka përfunduar në fund **të Marsit 2004**. Sipas deklaramit personalisht te Personit të Trete S. A. e **në Prill të 2004 është inauguruar** pasi të gjitha dhomat(27) ishin të kompletuara, hoteli punonte me kapacitet të plotë, kishte tre kate, dhe bodrumin Restorantin. Ai u shpreh se nga fundi i Dhjetorit 2003 deri në fund të Marsit të vitit 2004, ka qenë në Shqipëri dhe ka bërë punime në hotel, punime guri, lysterje me bojë, punimet e gipsit, rregullimet e banaqeve pasi këto nuk ishin të përfshira sipas marrveshjes me firmën. Për këto punime ai ka investuar në vijimësi shumë prej **60 mijë dollarë** si për pagesat për punëtorët edhe për blerjen e materialeve. Duke pretenduar se shtetasi S. A. kishte harxhuar mbi këtë object një shumë prej 220 mijë dollarë në bashkëpronësinë me të paditurin A. dhe fitimi i hotelit është përcaktuar prej të dyve se do ndanin **nga 3 mije dollarë** në muaj secili por që nuk I janë dhënë prej tij për shkak se I padituri A. kishte marrë borxh dhe në vende të tjera dhe ka marrë nga ai vetem 13 mijë dollar në Tetor apo Nënëtor të vitit 2007. Në vitin 2005 kanë marrë lejen për shtetsën për dy kate plus papafingo, që është e

papërfunduar. Në kushtet kur sipas llogarive për tre vitet 2004, 2005, 2006 I takonte të merrte një shumë prej 360 milion lekësh nga hoteli dhe nuk kishte marrë gjë deri në ato moment, është bindur që me një akt noterial kontrate në Dhjetor të vitit 2006, ku A. ka deklaruar shumën e parave që ai kishte dhënë e që si rezultat I takonte xx përqind e objektit atij dhe 20 përqind A. .

Nga S. A. u deklarua se nga viti 2001 ka firmë ndërtimi në Greqi e të deklaruar për çdo vit nga viti 2001 e në vijim, janë 40 mijë euro në vit, por nuk i ka dokumentat e deklarimit, por sipas tij, në krahasim me ato të deklaruar kanë qenë me të mëdha të ardhurat si dhe puna e bashkëshortes por edhe këto të paregjistruara. Ai ka deklaruar se të gjitha bisedat me firmën e ndërtimit si dhe dhënien e xxxxvë apo përpilimin e kontratës në xxxxx të xxxx me firmën e ndërtimit ai nuk ka dashur ti formalizojë duke u shënuar dhe emir I tij në to apo ti shohë pasi ishte I angazhuar në shtetin grek e I ka bërë vetëm A. meqë nuk kishte probleme e kishte besim te ai. Ai pretendoi se edhe leja apo investimi kishin dalë në emër të A. pasi nuk e kishte parë të arsyeshme të paraqitej dhe ai si bashkëpronar. Në këtë objekt. **Shumën e dhënë A. prej 120 mijë dollarë I ka sjellë nga Greqia në cantë, në makinë, nuk I ka deklaruar në kufi, e I ka lënë te I vëllai në Velmisht duke I thënë tia japë A. për çdo problem??!** Mirëpo ai shprehet se ka deklaruar një herë për në dalje të Shqipërisë në hyrje të shtetit Grek një shumë prej 15 mijë euro që do ti conte në Greqi për aktivitetin që kishte.

Shtetasi S. në lidhje me deklarimin e firmës së ndërtimit shprehet se ka patur shumë punëtorë që nuk i siguronte ai por vetëm veten e tij dhe i ka llogaritur mesatarisht një milion e gjysëm lekë të vjetra shqiptare në muaj të kursyera nga jetesa me familjen në Greqi dhe nga ana tjetër mbi shumën e kursyer nuk di të japë përgjigje.

Për të gjithë këta dëshmitarë, Gjykata kërkoi që të sqaronin rrethanat e dhënies hua, burimin e këtyre parave që i kanë dhënë A. H. për Investim në këtë objekt dhe u pa qartë në gjykim besueshmëria dhe bazueshmëria e deklarimeve të tyre dhënë në gjykim.

Ndërsa për dëshmitarin N. Z. , i cili pretendoi se ka ndërtuar shtesën anësore e papafingon dhe se ende nuk është paguar nga i pandehuri A. H. , gjykata kërkoi sqarime për pasqyrimin e kësaj pune të tij në organet tatimore.

Në varësi të përgjigjeve dhe provave shkresore që ata, apo mbrojtja e të paditurit A. H. paraqitën në këtë gjykim, Gjykata vlerëson dëshminë e

këtyre dëshmitarëve në procesin parandalues kundër pasurive të të paditurit A. . Në këtë përfundim arrin gjykata sepse në këtë proces sipas nenit 22/1 të ligjit parandalues, “...zbatohen, për aq sa është e mundur, dispozitat e Kodit të Procedurës Civile”. Në këtë këndvështrim, Gjkata në vlerësimin e deklaramit të dëshmitarëve mbështetet në parashikimin e nenit 232 të K.Pr.Civile sipas të cilit **“Nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë. Gjithashtu nuk lejohet të provohet me dëshmitarë marrëveshja e palëve për ndryshimin e kontratës ose shuarjen me anë pagimi ose faljeje e detyrimeve në të holla që rrjedhin nga një kontratë që është bërë ose duhej bërë me shkresë...”**

Në të njëjtat kushte, Gjkata vlerëson se edhe pretendimet e Palës së Tretë S. A. , i nënshtrohen verifikimeve në gjykim në ballafaqim me provat shkresore që ai, “si person që kërkohet t’i merret pasuria”, ka detyrimin që të paraqesë në këtë gjykim.

Në këtë gjykim, **Pala e Tretë, S. A. nëpërmjet mbrojtëses F. A. në bisedimet përfundimtare, për të justifikuar burimin e shumës së paguar në mënyrë të drejtpërdrejtë prej 220 000 USD, pretendoi se ka pasur aktivitet tregëtar në Greqi**, se atje ka pasur depozita bankare, por paratë i ka sjellë “dorazi” në çanta e pasi i ka futur kështu në kufirin shqiptar i ka transportuar në këtë mënyrë tek i padituri A. , në shtëpinë e tij në Durrës. **Mbrojtja e tij paraqiti, në formën e kërkuar nga ligji një sërë provash shkresore, dokumenta të punësimit të tij dhe bashkëshortes së tij në Greqi**, ku pasqyrohen edhe të ardhurat vjetore të deklaruar prej S. A. në zyrën fiskale Halkidha të prefekturës së Eubesë, Greqi. Sipas këtyre dokumenteve rezulton se S. A. ka hapur licence në datën 19.01.2001 me objekt shtrim pllakash, lyerje, veshje ndërtim. Këtë objekt e ka shtuar në datën 21.01.2008 duke përfshirë edhe xxxxx me shumicë e pakicë të materialeve të ndërtimit dhe të drurit. Po kështu vetë pala e Tretë paraqiti dokumente shkresore që tregojnë të ardhurat e deklaruar nga ai si Person Fizik në zyrën fiskale Halkidha të prefekturës së Eubesë, Greqi nga rezulton e provuar se :

- nga viti 1998 deri në vitin 2002 ka kursyer 7249 euro,
- ndërsa në vitin 2003, ka kursyer 5 907,7 euro dhe
- në vitin 2004 ka mundur të sigurojë 3 374,6 euro.

Ndërsa bashkëshortja e tij M. A. ka deklaruar të ardhurat si vijon:

-për vitin 2003 shumën prej 6930.2 euro

-për vitin 2004 shumën prej 2923,0 euro

Gjykata vlerëson se këto dokumente të paraqitur nga vetë kjo palë në proces, në kuptimin e nenit 254 të K.Pr.Civile, përbëjnë provë të plotë dhe lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e fallsifikuar. Meqënëse Personi i Tretë deklaroi se vlerën monetare prej 220 000 USD ia ka dhënë të paditurit A. H. brenda muajit Mars 2004, Gjykata vlerëson se, të ardhurat e realizuara prej bashkëshortëve A. **pas vitit 2004 nuk kanë asnjë rëndësi** për këtë proces.

Po kështu, nga **analiza tërësore e të ardhurave të ligjshme** të deklaruara nga familja A. , **Gjykata konkludon** se, ndryshe nga sa deklaroi në gjykim dhe pretendon në këtë proces gjyqësor ai dhe mbrojtja e tij, **Pala e Tretë S. A. nuk ka pasur asnjë mundësi objektive financiare për të dhënë hua apo për të investuar shumën e pretenduar.**

Për më tepër, pretendimi i Palës së Tretë S. A. se në periudhën xxxxx-xxxx, ka tërhequr paratë që ka pasur të depozituara në bankat e vendit ku ndodhej në emigracion dhe i ka sjellë në Shqipëri për të paguar firmën ndërtuese e shpenzimet e tjera në objektin e kërkesës për konfiskim, jo vetëm nuk u provuan prej tij, por prej dokumenteve shkresore që ai paraqiti në këtë gjykim, u provua e kundërta. Së pari ai ka tërhequr para nga Shqipëria e i ka cuar në Greqi si në rastin e detyrueshëm të deklarimit në kufi të shumës që do të fuste në Greqi prej 15 000 euro. Po kështu këtë pretendim të tij e rrezon edhe fakti i provuar me dokumentin e sjellë nga Pala e Tretë që vërteton se **se në datën 22.04.2008, S. A. ka pasur gjendje në Bankën e Pireut Greqi shumën prej 60 500 euro.**

Nga analiza e të gjithë dokumentacionit të deklaruar prej tij në zyrën fiskale të vendit ku ka punuar si emigrant, rezulton se kjo shumë e depozituar është e përafërt me shumën që rezulton nga mbledhja e të gjithë të ardhurave të deklaruara prej tij e bashkëshortes së tij, çka konfirmon jo vetëm vërtetësinë e dokumenteve shkresore të paraqitur si provë nga vetë kjo palë ndërgjyqëse, por bind gjykatën në pamundësinë absolute të vlerave të ligjshme monetare të tij që të investonte në objektin e ndërtuar nga i padituri A. H. .

Fakti që Personi i Tretë nuk ka investuar në objektin e konfiskimi rezulton jo vetëm nga pamundësi absolute e tij për të realizuar një investim të ligjshme, në raport me ta ardhurat që ai ka patur mundësinë të sigurojë, por

edhe sepse, ndryshe nga sa pretendon mbrojtja, edhe **Kontrata noteriale nr xxxx/xxx/x kol të nënshkruar në datën 31.12.2006**, para noteres A. Sh., nuk është një provë në favor të Palës së Tretë.

Gjykata analizon përmbajtjen e **kontratës së mësipërme, noteriale të xxxx**, të paraqitura nga palët në këtë proces dhe rezulton se palët nënshkruese, para noteres A. Sh. , me vullnetin e tyre të lirë kanë deklaruar se: **S. A. i ka dhënë xxxx në dorë A. H. , në datën 03.04.2004** një shumë prej 220000 USD. Kjo shumë është dhënë me afat pese vjecar dhe përfundon në datën 03.04.2009. Palët kanë rënë dakort edhe për interesin që duhet të paguhet si dhe për pasojat në rast mospërmbushje që është: sipas nenit 51/d e 511 të K.Pr.Civile kjo kontratë bëhet titull ekzekutiv dhe vihet në ekzekutim. **Si barrë detyrimi** është përcaktuar pasuria **“një sipërfaqje toke truall 600m2** në zonën kadastrale xxxx...”

Pra palët, si i padituri A. edhe Personi i Tretë S. , para noterit nuk kanë shprehur asnjë marrëdhënie tjetër mes tyre për probleme të ndërtimit apo investimit në ndërtesën Bar-Restorant-Hotel, objekt gjykimi dhe se, ndryshe nga sa pretendohet me deklarime mnë seancë gjyqësore, rezulton se shuma e pretenduar prej 220000 USD, është dhënë në datën 03.04.2004, **kur po sipas tyre investimi në objekt kishte përfunduar.**

Gjykata vlerëson se, bazuar në nenin 253 të K.pr.Civile, kjo kontratë, për sa i përket marrëdhënieve juridike që krijohen apo legjitimohen, midis të paditurit A. H. dhe Përsonit të Trete, S. A. , përbën provë të plotë për veprimet e kryera prej tyre e të deklaruara para noterit, **ndërsa për personat e tjerë**, përfshirë edhe **shtetin** Shqiptar, të përfaqësuar nga Prokurroia për Krime të Rënda në këtë proces gjyqësor, sipas parashikimit të **nenit 234 të K.Pr.Civile**, **nuk ka të njëjtën fuqi** sepse **“personi i tretë është i lirë në paraqitjen e provave”**, tej përmbajtjes së veprimt juridik të kryer nga të tjerët. Në këtë kuptim kjo kontratë nuk përbën provë të plotë për të justifikuar pasurinë, nëse nuk konfirmohet nga prova të tjera.

Në këto kushte Gjykata cmon se shuma e pretenduar edhe nëse është dhënë, nga Personi i Tretë S. A. , të paditurit A. H. , e dhënë në datën 03.04.2004, nuk ka lidhje me objektin e konfiskimit, madje në kushtet e përcaktimit të vullnetit të palëve se në arst mos kthimi, do të jetë si marrë pasuria toke truall, Gjykata vlerëson se agjë nuk e lidh këtë akt noterial me pasurinë objekt gjykimi(sipërfaqja e tokës nuk është objekt konfiskimi).

Mbi bazën e provave e akteve të marra në shqyrtim në këtë gjykim, **Gjykata konkludon se pretendimet e palës së Tretë S. A.** për investim në objektin e kërkesës për konfiskim, **nuk u provuan në gjykim** e për rrjedhojë nuk mund të pranohen nga

gjykata, ndërsa pretendimet e të Paditurit A. H. , pranohenvetëm pjesërisht, duke pranuar si të ligjshëm investimin e bërë deri në fazën e ndërtimit të pjesës së pasurisë së cilësuar si « **xxxxxx me sipërfaqjen xxxmx** ». **Në këtë përfundim arrin Gjykata sepse :**

Së pari : Gjykata vlerëson se, mbështetur në nenin 3/1 e ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Njëpërmjet Masave Parandaluese kundër pasurisë”, në rastin në gjykim, bindet se kushti i parashikuar në këtë dispozitë për « Dyshimin e arsyeshëm të mbështetur në « indicje » për pjesëmarrje në një ndër veprat penale të parashikuara shprehimisht nga ligjvënësi, është më shumë se i plotësuar.

Gjykata cmon se pretendimi i të paditurit A. se është i pafajshëm e nuk është përfshirë në « Trafikimin e narkotikëve », nuk ka asnjë bazë e nuk mund të merret në konsideratë. Në këtë gjykim u paraqit si provë nga akuza Vendimi nr. 10 datë 26.03.2010 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, sipas të cilit, midis të tjerave, është vendosur edhe **deklarimi fajtor i të pandehurit A. H. për veprën penale të “Trafikimit të lëndëve narkotike » të kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal dhe e ka dënuar atë përfundimisht me 10 vjet e 8 muaj burgim. Rezulton se ky vendim ka marrë formë të prerë dhe aktualisht i padituri A. H. është duke vuajtur dënimin e dhënë, pikërisht për një nga veprat që e cilësojnë atë si subjekt sipas ligjit 10192 datë 03.12.2009.**

Mbështetur në arsyetimin e vendimit gjyqësor që ka gjetur fajtor të paditurin A. H. dhe në provat shkresore të paraqitura nga akuza në këtë gjykim, gjykata bindet se i padituri(i dënuari) A. H. , është subjekt i ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 « Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar dhe trafikimit njëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive » sepse vepra penale për të cilën është gjetur fajtor me vendim gjyqësor, hyn në kategorinë e veprave penale të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligji.

Gjykata vlerëson se për të paditurin A. H. efektet e ligjit 10 192 datë 03.12.2009, **veprojnë mbi pasurinë e tij, por në bazë të nenit 3 / 4 të këtij ligji** këto efekte shtrihen, vetëm për periudhën pas përfshirjes së tij në

veprimtarinë kriminale për të cilën është gjendur fajtor dhe është dënuar.

Lidhur me kushtin e parashikuar në nenin 3/ 4 të ligjit të sipërcituar, Gjykata, në bazë të provave të marra në shqyrtim në këtë gjykim, e posaçërisht nga pjesa arsyetuese e **Vendimit nr. 10 datë 26.03.2010 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda**, bindet se rezulton se i gjykuari A. H. është **gjendur fajtor për 11 episode kriminale** të trafikimit të lëndëve narkotike e konkretisht në **datat 17.02.2003** ; 16.03.2003 ; 03.04.2003 ; 14.05.2003 ; 01 dhe 06 Korrik 2003 ; 06 dhe 22 Gusht 2003 ; 17.09.2003 dhe **01.11.2003.**

Ndërsa, siç është evidentuar edhe në Vendimin e Sekuestrimit të pasurisë objekt konfiskimi, ekzistojnë indicje se i padituri A. H. është përfshirë në aktivitetin e trafikimit të lëndëve narkotike, për të cilën është dënuar disa kohë përpara realizimit të episodit të **datës 17.02.2003**. Kështu nga të dhënat që japin përgjimet telefonike mes të dënuarit A. e bashkëpunëtorëve të tij, si dhe nga veprimet e tjera hetimore të kryera nga autoritetet gjyqësore të shtetit Italian, rezulton se minimalisht ata provohet se janë marrë me trafikim të lëndëve narkotike në fillim të xxxxxit xxxx **pasi në datën 21.01.2003** është arrestuar shtetasi shqiptar B. N. , me 38 kg lënde narkotike e llojit heroinë, dhe se pjesë e trafikimit të kësaj lënde narkotike kanë qenë edhe bashkë të pandehurit e këtij rrjeti kriminal. Madje, Gjykata vlerëson se nga provat e ndodhura në fashikull rezulton se **përfshirja e të paditurit A. H. , në veprimtarinë kriminale që është dënuar, mund të shtrihet që në ditën kur ka mbërritur në Itali lënda narkotike dhe ai së bashku me shokët tij janë vënë nën përgjim, pra që në datën 12.01.2003 kur autoritetet Italiane kanë filluar gjurmimin e aktivitetit të grupit kriminal ku bënte pjesë edhe A. .**

Ndërsa objekti i kërkesës për konfiskim, ka filluar t'ën dërtohet në datën 29.01.2003.

Së dyti: Gjykata vlerëson se **pasuria objekt gjykimi**, me të gjithë plotësimet që u bënë gjatë hetimit gjyqësor nga verifikimi e matja në vend që bëri ekspert S. K. me matjet në vend është krijuar dhe ka qenë në posedim, deri në ditën e ekzekutimit të Vendimit të kësaj Gjykate për sekuestrimin e saj.

Ndonëse i padituri A. H. nuk e ka regjistruar **pasurinë e ndërtuar** mbi truallin prej xxx mx, për efekte të ligjit parandalues, ndryshe nga sa pretendon mbrojtja, Gjykata vlerëson se kjo pasuri, bazuar në nenin 6 të ligjit 10192 datë 03.12.2009 si dhe frymës tërësore të dispozitave të këtij ligji, duke qenë një pasuri që provohet se është përdorur për të shtuar fitime dhe gjëndet në

posedim të drejtpërdrejtë të të paditurit A. dhe familjarëve të tij, **përfshihet nën efektet e ligjit parandalues** dhe se personat që e pretendojnë pronësinë e këtij sendi duhet të justifikojnë ligjshmërinë e vënies së tij.

Së treti: Barra e provës për të justifikuar pasurinë që kërkohet të konfiskohet, e kanë personat që pretendojnë pronësinë mbi sendin objekt konfiskimi.

Gjykata vlerëson se I padituri A. H. nuk ka pasur mundësi financiare të ligjëshme për të ndërtuar objektin e kërkesës për konfiskim.

Pretendimi i tij se ka marrë hua apo se ka investuar në këtë objekt daja i tij S. A. , në shumën prej 220000 USD, nuk u provua në gjykim.

Nga provat e marra në shqyrtim në këtë gjykim, **Gjykata bindet se Personi i Tretë S. A. nuk ka pasur asnjë mundësi të investojë të ardhura të ligjëshme në këtë pasuri.**

Fakti se ai ka qënë emigrant në Greqi nuk justifikon shumën e pretenduar prej tij se në periudhën Gusht 2002-Mars 2003 ka patur në gjëndje dhe i ka dhënë nipit të tij, A. H. shumën prej 220 000 dollarë, por për këtë ka bërë kontratën e huase vetëm në datën 31.12.2006 në të cilën, ndryshe nga sa deklaroi në seancë gjyqësore ka deklaruar se ja **ka dhënë njëherësh cash, në datën 03.04.2004..**

Ndonëse, në bazë të nenit 253 të K.pr.Civile, kjo kontratë prodhon efekte juridike vetëm për marrëdhëniet mes palëve të saj, pas datës së nënshkrimit të saj tek noteri, Gjykata pranoi të dëgjonte palët në pretendimet e tyre për rrethanat e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe pretendimet e tyre se ajo përmbyll marrëdhëniet e lindura më parë, në periudhën Gusht 2002-Mars 2004 mes tyre. Nga provat e sjella nga vetë pala e Tretë në Gjykim rezultoi se Personi i Tretë S. A. , **nuk ka deklaruar** në asnjë rast në kufi, sipas rregullave doganore, që të **ketë sjellë vlera monetare nga Greqia në Shqipëri**, ndërsa ka rezultuar një rast i kundërt kur ka marrë para në Shqipëri dhe i ka dërguar në Greqi, të cilat edhe i ka deklaruar në pikën kufitare përkatëse madje një vlerë të konsiderueshme prej 15 000 euro. Ky deklaram është bërë prej tij në datën 15.06.2006 dhe Personi i Tretë e mbrojtja e tij nuk shpjegojnë se nga ka rrjedhur kjo pasuri monetare, ndërsa eksperti e përfshin në mundësinë financiare të këtij personi për të investuar në pasurinë objekt gjykimi?!

Personi i Tretë në deklaramet e tij **pretendoi se kishte pasur depozita bankare në Greqi**, të cilat i kishte mbyllur, shumat i kishte konvertuar në dollarë dhe i kishte sjellë për të investuar në Hotelin e nipit të tij A. . Me gjithë mundësinë që iu dha nga gjykata **nuk u paraqit asnjë dokument**

shkresor për të provuar këtë pretendim, që duhet ti referohej gjendjes së tij në periudhën Gusht 2002- Mars 2004 (kur pretendon se ka dhënë shumat e pretenduara nipit A.);

Në të kundërt me këtë, Personi i Tretë dhe mbrojtja e tij paraqitën depozitën bankare të këtij shtetasi sipas së cilës në **datën 22.04.2008 ai kishte gjendje në bankën e Pireut Greqi shumën prej 60 500 euro.** Gjykata e vlerëson se kjo vlerë monetare është e ligjshme për familjen A. , por data e gjendjes së saj në Bankë tregon se jo vetëm nuk mund të përfshihet në mundësitë e Personit të Tretë që të përdorte këtë shumë për ti dhënë hua nipit të tij A. (sepse ai pretendon se ka përfunduar dhënien e shumës ne Mars 2014), por se duke u mbështetur edhe në deklaratat e të ardhurave vjetore që Personi i Tretë dhe familja e tij, kanë dhënë para autoriteteve tatimore të shtetit Grek, kjo shumë mund të jetë vlere maksimale e mundëshme e kursyer nga kjo familje emigrante nga puna në Greqi.

Lidhur me përmbajtjen e deklaratës noteriale të datës 21.04.2008, Gjykata vlerëson se nuk ka asnjë vlerë për këtë gjykim, sepse është një deklaram që nuk mund të përdoret në gjykim, për më tepër që përmbajtja e saj vjen në kundërshtim me aktin noterial si më sipër u arsyetua në këtë gjykim, dhe se gjykata i dëgjoi drjetpërdrejt palët në seancë gjyqësore.

Gjithsesi, Gjykata thekson se deklaratat noteriale, të nënshkruara nga një apo më shumë persona, nuk mund të përdoren në gjykimin parandalues, nëse deklaruesit janë gjallë e mund të deklarojnë vetë para gjykatës.

Rezulton gjithashtu se S. A. ka pasur një banese në Patos të cilën e ka shitur në vitin 1999 në shumën 650 000 lekë, por ai njëkohësisht provohet se ka ndërtuar në fshatin e tij , në Velmisht një banesë e cila ende është në proces legalizimi dhe në ndërtim e sipër me vlerën aktuale të shpenzuar për të në shumën rreth 2 500 000 lekë.

Lidhur me pretendimin se Personi i Tretë ka marrë hua në datën 23.03.2004 shumën prej 60 000 euro nga një shtetas i quajtur I. R. , Gjykata vlerëson se nuk mund të merret në konsideratë si burim i ligjshëm e mundësi investimi në objektin e konfiskimit sepse:

-Personi i Tretë S. A. në deklaramet e spjegimet e dhëna prej tij personalisht në seancë gjyqësore, nuk e përmendi këtë fakt, por pohoi se paratë që i ka dhënë A. , i ka siguruar nga puna e tij e se i ka pasur në depozitë në Greqi. Vetëm pas kryerjes së hetimit gjyqësor dhe pas aktit të ekspertimit kontabël të kryer në gjykim, nga i cili rezultoi pamundësia finaciare

e tij për të kursyer para nga puna e ligjshme në emigracion, Mbrojtësja paraqiti këtë kontratë huaje, pa sqaruar asnjë rrethanë tjetër se përse ishte detyruar në atë periudhë Personi i Tretë të merrte hua.

-Për më tepër në gjykim, nga pala që ka barrën e provës, as nuk u sqaruan e as nuk u provuan rrethanat se kush është ky person, cili ishte burimi i të ardhurave të tij, ku i kishte këto para që ia ka dhënë “borxh” A. , në çfarë mënyrë i ka transferuar apo dorëzuar tek ai dhe cila është marrëdhënia e tyre aktualisht: a i ka shlyer apo jo këto para Personi i Tretë, në kushtet kur ai ende ka gjendje në llogari bankare shumë prej 60 500 euro, apo vijon të paguajë interes etj.

-Edhe nëse i ka marrë këto para hua, nuk i ka përdorur në këtë investim sepse sic edhe ka deklaruar në seancë gjyqësore, punimet e rafinaturës i ka filluar në mujin Dhjetor 2003 e i ka përfunduar në Mras 2004, dhe se shumë prej 60 000 euro e ka shpenzuar për pagimin e punëtorëve, për blerjen e materileve e të paisjeve, të cilat në një investim normal paguhen pjesë pjesë, si procese të punës dhe likuidimi është bërë po kështu që në Dhjetor 2003 e ne vijim e nuk ka mundësi që të pritej marrajh e këtij borxhi që të paguheshin punimet e kruera më parë. Pa paragjykuar marrëdhëniet mes **Personit të Trete S. A. me “huadhensin “ e tij I. R. , Gjykata vlerëson se kjo kontratë huaje nuk ka asnjë lidhje me vlerën e shpenzuar për të ndërtuar objektin e konfiskimit dhe nuk mund të përfshihen në shumë të ligjëshme të investuar në këtë objekt.**

Në këto kushte, **Gjykata bindet se ndryshe nga sa pretendon në këtë gjykim Pala e Tretë e mbrojtja e tij, por edhe i padituri A. H. , shtetasi S. A. , nuk provuan që të kenë pasur mundësi financiare që të investojë as si bashkëinvestitor e as si huadhënës për ndërtimin e objektit Bar-Restorant Hotel, objekt konfiskimi, në asnjë prej fazave të ndërtimit të tij.**

Prandaj, Gjykata vlerëson se për rrethanat e sqaruara më sipër rrëzohet si i pa mbështetur në prova pretendimi i të paditurit A. H. se në këtë objekt ka investuar daja i tij, shtetasi S. A. i cili ndërhyri si Person i Tretë në këtë Proces.

Ndërsa lidhur me burimet e tjera të financimit që i padituri A. H. , pretendon se ka përdorur për të investuar në këtë objekt, Gjykata, duke u mbështetur në rregullat procedurale të sqaruara më sipër lidhur me vlerën e dëshmisë në këtë proces, vlerëson se nga tërësia e vlerave monetare që i Padituri A. H. pretendon se ka investuar në pasuritë e paluajtëshme dhe të luajtëshme që janë gjendur në pronësi të tij (pra jo vetëm në objektin e ndërtuar,

por edhe për xxxxx e xxxxx truall), vlen të vihen në diskutim vetëm ato të ardhura për të cilat u paraqitën prova shkresore në këtë gjykim.

I padituri A. ka pretenduar se ka marrë hua nga **komshiu K.**, si dhe i ka mbetur pa dhënë paratë **dëshmitarit Z.** i cili paska kryer punimet në ndërtimin e pjesë së papafingos së xxxxx.

Lidhur me këto pretendime, që pala e Paditur kërkoi ti provojë vetëm me thirrjen e tyre si dëshmitarë, Gjykata konkludon se nuk qëndrojnë e nuk mund të pranohen. Dëshmitë e dëshmitarëve që nuk konfirmohen me prova shkresore, mbeten vetëm pretendime në këtë proces dhe nuk mund të merren në konsideratë. Në këtë përfundim arrin gjykata sepse vlerëson dëshmitë e dëshmitarëve apo edhe pretendimet e Të Paditurit, në lidhje me përmbajtjen e nenit 232 e 234 të K.Pr.Civile. Pretendimi i mbrojtjes së dëshmia e dëshmitarëve përbën provë të plotë në këtë gjykim, sipas parashikimit të nenit 233 të K.Pr.Civile, jo vetëm nuk qëndron, por edhe do te vinte në kundërshtim me frymën tërësore të ligjit parandalues. Për më tepër që në këtë proces, shteti, nëpërmjet Prokurorisë për Krime të Rënda, është palë e tretë në lidhje me marrëdhëniet e të Paditurit A. me dëshmitarët e thirrur në gjykim.

I padituri A. ka pretenduar se ka marrë hua edhe nga vjehrra K. (nëpërmjet **kontratës së huasë së vitit 2010** të nënshkruar mes saj e vajzës së saj X.).

Fillimisht Gjykata sqaron se sipas kontratës së pretenduar rezulton se është lidhur para noterit në periudhën kur ndaj të paditurit A. H. **kishte nisur procedimi pasuror**, prandaj në bazë të nenit 22/5 të ligjit 10 192 datë 03.12.2009, për efekte të këtij procedimi ky është nje veprim juridik fiktiv e i pavlefshëm.

Por edhe nëse do të shmangeshim nga kjo dispozitë, përsëri bazuar në përmbajtjen e kësaj kontrate, se shuma pre 5 000 000 lekë është marrë hua në datën 02.08.2006, nuk sjell efekte për këtë proces sepse në këtë kohë nuk është bërë investim në objekt, pasi edhe për punimet e shtesës i padituri Pretendon se nuk i ka paguar ndertuesit.

Për më tepër, në kushtet kur palët e asaj kontrate janë edhe vetë subjekte të ligjit parandalues, gjatë këtij gjykimi u provua se pala huadhënsë K. B. nuk kishte asnjë mundësi që të jepte këtë shumë parash borxh vajzës së saj, sepse ndryshe nga sa dëshmoi në këtë gjykim, nga provat shkresopre rezultoi se në datën 01.08 2006, S. B. , nuk ka fituar ndonjë të ardhur

nga shitja e pasurisë së paluajtëshme sepse në të njëjtën ditë rezulton se ka shitur një shtepi dhe ka blerë një tjetër me të njëtin cmim prej 2 000 000 leke, me të njëjtën palë L. H. dhe vullnetine kanë shprehur përpara të njëjtuit noter E. XH . A. .Pra në fakt ata ka realizuar **një kontratë shkëmbimi**, që e kane formalizuar me kontratë shitje e blerje të njëhërshme të pasurive të secilës palë.

Ndërsa nga verifikimi i bërë ka rezultuar se bashkjeshortja e të paditurit A. H. , dëshmitarja **X. H** , ka blerë edhe pasuri të tjera të paluajtëshme në **Durrës**. Kështu në këtë gjykim u provua se në **datën 31.05.2007** ajo ka blerë tek firma “xxx xxx xxxxxxxxx” sh.p.k, të përfaqësuar nga z. A. H. , **një garazh me sipërfaqje 14.7 m2 me cmimin 397 980 leke** si dhe në datën **13.07.2007** ka blerë pasurinë tjetër **Apartamentin nr 5 me sipërfaqje 124.36 m2 me cmimin 4.900.760 lekë**, pra për të dyja këto pasuri ka shpenzuar rreth **5 300 000(pesëmiljaon e treqind mijë) lekë**. Megjithëse kjo pasuri nuk është në objektin e këtij gjykimi, Gjykata e vlerëson atë në lidhje me pretendimet e të paditurit A. për ligjëshmëri e investimit të objektin “Bar-Restporant-Hotel”.

Si ka mundësi që ndërkohë që ishte i zhytur në borxhe tek njerëz të afërm e të pa njohur, ndërkohë që i trokisnin e i trokasnin për shlyerjen e tyre apo që detyrohet të lidhe kontrata huaje e të bëjë deklartata noteriale, I padituri A. dhe Bashkjeshortja e tij bëjnë investime të tepra jo pak të fuqishm? Ku u gjend kjo shumë parash në vitin 2007?

Në këto kushte Gjykata bindet se edhe nëse X. H. ka marrë hua tek njerëzit e saj, (nëse do të provohej se nëna e saj K. kishte përfituar si ish pronare apo i kishte dhënë e ëma e saj vlera të tjera që ajo deklaroi), pra edhe nëse do të provoheshin këto rrethana, përsëri shumë që pretendon se e ka marrë hua prej 5 milion leke, nuk e ka investuar në objektin e kërkesës për konfiskim. Këtë vlerë ajo e mund ta ketë harxhuar në krijimin e pasurisë së mësipërme, por në asnjë rast nuk ka mundur të investojë në ndertimin e objektit në konfiskim.

Duke vlerësuar si të paligjeshmë e të pajustificuar pasurinë e investuar në vitet 2003-2004 dhe Tetor 2005, Gjykata konkludon se edhe të ardhurat që mund të jenë përfituar nga shfrytëzimi i kësaj pasurie, ndryshe nga sa pretendoi i padituri A. , nuk mund të lloogaqriten si burim i ligjeshëm investimi në realizimin e shtesave apo të paisjes së objektit. Në këtë përfundim arrin

gjkata, jo vetëm nga fakti i provuar nëgjykim se kjo pasuri nuk është shfrytëzuar në mënyrë oermanente në periudhën para sekuestrimit, se licenca për aktivitetin në të është hapur e mbyllur disa herë , por edhe se më të ardhurat e fituara i padituri A. ka mbajtur familjen e tij në rritje nga dy në xxxx anëtarëshe, ka paguar interesat për borxhin që i ka marrë xxxxx K. prej, xx xxx xxxx në muaj etj. Veç kësaj, edhe nëse do të provohej xxxxxx i pretenduar nga i Padituri (i pa deklaruar në organet tatimore) përsëri të ardhurat e krijuara nga kjo pasuri nuk mund të vlerësohen nga Gjykata si “xxxx xxxxxx” sepse ato rrjedhin nga shfrytëzimi i dhe vënia në funksionim të një pasuri që është vënë në mënyrë kriminale.

Përfundimisht, Gjykata vlerëson se në burimin e të ardhurave që ka deklaruar i Paditur A. dhe mbrojtja e tij për krijimin e pasurisë objket konfiskimi, **vetëm vlera e depozitave bankare që kanë pasur nëna e tij N. H. dhe motra K. Ll.** , duhet të merret në konsideratë e të vlerësohet në lidhje me të gjitha rrethanat e çështjes në gjykim, nëse janë përdorur ose jo në këtë pasuri.

Nga provat me dëshmitare e shoqëruar me prova shkresore, provohet në gjykim se xxxx e të Paditurit A. H. , N. H. ka celur një depozitë bankare në bankën e **Kursimeve në datën 18.12.2001**, dhe se në datën 18.06.2002, sipas provës shkresore që paraqiti pala e Paditur, duhet të jetë maturuar depozita me afat sepse në këtë datë, pra në 18.06.2002 në këtë llogari kanë qënë gjëndje, shuma prej 10 000 000 lek. Po kështu provohet se **në datën 28.06.2002 N. H. ka pasur në llogari shumën prej 10 363 000 Lek.** Rezulton se nga kjo llogari bankare, në **datën 16.07.2002**, ajo ka tërhequr vlerën **prej 7 000 000(shtatë milion) lekë** duke lënë në depozitë shumën prej 3 000 000(tre milion)lekë.

Gjykata konstaton se shuma e tërhequr nga banka e kursimeve prej kësaj llogarie, **përkon me kohën kur i padituri A. H. ka blerë truallin prej xx0 mx** (vlerën e të cilit në atë periudhë eksperti e vlerësoi se ishte rreth 70 000 euro) sepse në gjykim u provua se kontratën e shitblerjes e ka nënshkruar tek noteri **në datën 02.09.2002, pra vetëm dy javë pas tërheqjes së kësaj shume parash.** Prandaj Gjykata vlerëson se këtë vlerë monetare i padituri A. , nuk e ka investuar ëpr ndërtimin e objektit, por e ka konsumuar për blerjen e pasurisë së palushtëshme, tokës truall mbi të cilin undërtua objekti.

Pjesa tjetër të kësaj depozitë, Gjykata konstaton se është tërhequr në

datën 29.12.2004, që megjithë interesat ka kapur vlerën prej **3 283 131 lek**, dhe **Gjykata**, ndryshe nga sa pretendoi akuza, **vlerëson se kjo shumë** duhet të llogaritet si shpenzim i investuar në mënyrë **të ligjshme** në pasurinë objekt gjykimi.

Ndërsa motra e tij, **dëshmitarja K. Ll.**, në një llogari të përbashkët me nënë e saj **N. H.**, **në datën 27.09.2002** ka patur, e ka tërhequr dhe e ka riderdhur ne bankën BK Tregëtare Durrës shumë prej **5 000 0000 lekë**. Në këtë llogari lëvizja e tillë është bërë disa herë dhe rezulton se është tërhequr shuma e mësipërme **në datën 14.10.2003**, kohë në të cilën objekti ishte ende në ndërtim, prandaj Gjykata vlerëson se edhe kjo shumë duhet të llogaritet si pasuri e ligjshme e investuar në objektin e kërkesës për konfiskim.

Gjykata sqaron se, për vlerat monetare të sipërcituara, të depozituara në Banka përpara datës kur dyshohet se i padituri A. është marrë me veprimtarinë kriminale për të cilën është gjendur fajtor dhe është dënuar, kur ato janë tërhequr e konsumuar gjatë periudhës së pretenduar se është krijuar pasuria që pretendohet të vihet nën masat e ligjit parandalues, prezumohet pasuri e ligjshme. **Gjykata, ndryshe nga sa pretendon akuza, vlerëson se**, në bazë të nenit 3/4 të Ligjit nr. 10192 datë 03/12/2009, si i Padituri A. edhe të afërmit e tij, nuk kanë detyrimin të provojnë ligjshmërinë e vënies së këtyre parave apo **burimin e ligjshëm të kësaj pasurie**.

Në këto kushte, mbështetur në rrethanat e provuara në gjykim, nga dëshmitë e dëshmitarëve të thirrur nga mbrojtja në këtë gjykim, në provat shkresore si më sipër u analizuan, Gjykata vlerëson se mund të marrë në konsideratë vetëm dëshminë e dëshmitares K. Ll., dëshmia e së cilës për dhënien hua të shumë prej 5 000 000 lek, si dhe pretendimin e të paditurit A. se nga nena N. H. ka marrë depozitën prej rreth 10 000 000 lekë, u mbështetën me provat shkresore që u paraqitën në gjykim.

Por ndryshe nga sa pretendon mbrojtja, Gjykata vlerëson se kjo shumë monetare është investuar vetëm pjesërisht në ndërtim, sepse pjesa më e madhe e saj është investuar pa filluar ndërtimi, në **blerjen e truallit xxx mx**, vlera e të cilit e shprehur në kontratën e shitblerjes nuk është reale. Sipas vlerësimit të ekspertit S. K., rezulton se në momentin e blerjes prej të paditurit A. H., në Gusht të vitit 2002, trualli prej xxx mx ka patur vlerën e tregut prej **72 000 euro ose 120 euro/m²**

Gjykata sqaron se në themel të këtij vendimi gjykata mban në konsideratë konkluzionet e ekspertëve, për aq sa ato gjenden në përputhje me provat e tjera të marra në gjykim.

Sipas aktit të ekspertimit kontabël të kryer nga eksperti Gj. H. i datës 20/07/2011, aktit të ekspertimit kontabël shtesë të datës 28/09/2011 dhe

shpjegimeve të dhëna në gjykatë rreth këtyre akteve rezultoi se : I Padituri A. H. , nuk ka pasur burime të ligjshme financiare, veç depozitës së nënës dhe të motres së tij, të provuar si më sipër në këtë gjykim. Lidhur me vlerat e tjera xxxxxx të pretenduara nga I Padituri, ndryshe nga sa ka konkluduar edhe eksperti kontabël, siç u sqarua më lart, Gjykata vlerëson se nuk mund të përfshihen si burime të ligjshme në këtë investim.

Kështu lidhur me vlerën e automjeteve të shitura në datat 26.08.2005 dhe 05.01.2006, Gjykata vlerëson se në kushtet kur nuk u paraqit kontrata e blerjes së këtyre mjeteve, për të mësuar si datën e blerjes edhe vlerën e harxhuar nga i padituri për blerjen e tyre, nuk mund të përfshihen prior në të ardhurat e ligjshme të të paditurit. Ato mund të kishin interes në këtë gjykim vetëm nëse pala e Paditur do të vërtetonte se janë blerë përpara Janarit 2002, ose edhe nëse janë blerë pas përfshirjes së të paditurit A. në veprimtarinë kriminale, janë blerë me një vlerë më të ulët dhe diferenca mund të ishte fitim, i llogaritur për interes të këtij gjykimi. Gjykata duke vlerësuar, në kushtet e mosparaqitjes së provave, se mjetet motorike amortizohen dhe se vlera e tyre në shitje është më e ulët se sa në blerje, konkludon se i padituri A. , në rastin më të mirë i ka shitur aq sa i ka blerë e për rrjedhojë nuk ka pasur fitim ose në rastin më të keq (për të) i ka shitur më lirë dhe për këtë ka harxhuar ca para më tepër e që duhet t' i justifikojë.

Ndërsa lidhur me pretendimin e të Paditurit se ka marrë hua nga vjehrra e tij, K. B. dhe mundësinë e njerëzve të bashkëshortes së tij për të dhënë hua, Gjykata bindet se pretendimet nuk u provuan në gjykim. Ndryshe nga sa dëshmoi dëshmitarja B. në seancë gjyqësore, nga provat shkresore të paraqitura në gjykim, rezulton se jo vetëm ka shitur një apartament, por edhe ka blerë një tjetër, brenda të së njëjtës periudhë, se nuk ka të ardhura të ligjshme të tilla që të japë mundësi për të dhënë hua 'dhëndërrit'.

Edhe lidhur me të ardhurat e krijuara nga aktiviteti në ndërtesën objekt konfiskimi, dhe përdorimin e tyre për ndërtimin e pjesës me lejen e ndërtimit në Tetor 2005 apo edhe të shtesës, Gjykata vlerëson se jo vetëm nuk u paraqitën prova shkresore të nevojshme për të provuar këtë aktivitet, por bindet se ai ka funksionuar me periudha të shkurtëra kohe aq sa nevojiten si shpenzime për pagesa dhe shpenzime të tjera si dhe për të garantuar jetesën e familjes H. , që në vitet 2003 e në vijim nuk rezulton se ka pasur burim tjetër të ardhurash dhe se sipas ekspertit ka qënë e nevojshme vetëm e llogaritur sipas minimumit jetik që i është dashur një vlerë **prej 3 358 553 lekë**.

Lidhur me pretendimin e të paditurit A. se ka punuar në emigracion, nuk u paraqit asnjë dokumentacion para Gjykatës, për më tepër që qëndrimi ishte kontradiktor lidhur me periudhën e punës në emigracion në raport me krijimin e pasurisë objekt konfiskimi.

Pra, ndryshe nga sa pretendon i Padituri A. H. dhe mbrojtja e tij në gjykim, **Gjykata vlerëson** se, veç shumave monetare që kanë qënë në depozitë

të nënës dhe motrës së tij, **nuk ka pasur asnjë mundësi tjetër financiare për të blerë tokën truall dhe për të ndërtuar më pas ndërtesën objekt konfiskimi.**

Në këto kushte, **ndryshe nga sa konkludon eksperti kontabël, Gjykata vlerëson se i padituri A. H. , nuk ka pasur mundësi objektive** për të ndërtuar objektin e konfiskimit me para të ligjshme. Ai nuk ka marrë shumën e pretenduar prej 220 000 dollarë nga daja i tij A. , për ndërtimin e objektit dhe nuk ka marrë borxh nga vjehrra, kunati apo komshiu i tij, ndërsa për punën e kryer në këtë objekt, në kushtet kur nuk u paraqit asnjë provë apo fillim prove me shpresë gjykata vlerëson se i ka shlyer të gjithë kontraktorët apo nënkontraktorët që i kanë kryer punime.

Gjykata vlerëson se i padituri A. ka investuar si të ardhur të ligjshme në këtë objekt vetëm vlerën e parave që ka marrë nga motra e tij K. Ll. në shumën rreth 5 000 000 lekë , sepse shumën e marra nga nëna Nadire, nga gjykimi rezulton se e ka konsumuar për të përballuar vlerën e truallit që ka blerë në Shtator 2002 si dhe pjesën e mbetur për të përballuar jetësën e tij nëkushtet kur nuk provoin se ai dhe bashkëshortja e tij nuk merreshin me asnjë aktivitet të ligjshëm..

Nga provat e marra në gjykim, rezulton se, vlera monetare që mund të konsiderohet e ligjshme është e përafërt me shpenzimin e bërë nga i padituri A. për ndërtimin e pjesës së bodrumit që, sipas llogaritjeve të ekspertit **ka një sipërfaqje prej xxx mx** me vlerë ndërtimi në momentin e krijimit prej 5 595,556.8 lekë. Prandaj, në bazë të nenit 24/1 pika “a” e ligjit 10192 datë 03.12.2009, Gjykata vlerëson se **kjo pjesë e pasurisë duhet të përjashtohet nga konfiskimi** sepse u provua në gjykim, krijimi në mënyrë të ligjshme i saj, ndërsa pjesa tjetër e pasurisë së krijuar nga i padituri A. H. , mbi truallin prej xxx mx , duhet të konfiskohet.

Në bazë të nenit 20/3 e 26 të ligjit 10192 datë 03.12.2009 shpenzimet procedurale të fazës së hetimit pasuror dhet ti ngarkohen të paditurit A. H. , ndërsa ato të shqyrtimit gjyqësor i ngarkohen solidarisht të paditurit A. H. dhe Personit të Tretë S. A. .Gjykata sqaron se për kryerjen e ekspertimeve , në bazë të faturave të paraqitura, eksperti vlerësues për vlerësimin e pasurisë “ Bar-Restorant- Hotel, në Durrës dhe banesë trekatëshe në Velmisht Fier është shpërblyer në **shumën totale prej 120 000 lekë**, ndërsa eksperti kontabël në **shumën 42 000 lekë.**

Gjykata sqaron se pjesa e pasurisë “**Bodrum-Disko**”, **me sipërfaqe prej xxx mx, nuk ka qënë objekt i kërkesës** për konfiskim sepse akuza ka kërkuar konfiskimin e objektit x + x/x kate me nga xxx m x cdo kat. Kjo pjesë e pasurisë as nuk është sekuestruar me Vendimin e kësaj Gjykate nr 10 datë 14.07.2010, megjithatë, duke qënë pjesë e pandarë e objektit që konfiskohet, si për të edhe për pjesën e shtesës anësore të objektit që nuk ishte llogaritur në kërkesën për konfiskim, Gjykata vlerëson se duhet të shprehet në këtë vendim.

Sa u arsyetua më lart, **Gjykata konfirmon ligjshmërinë e krijimit të pjesës së sipërcituar të pasurisë** si dhe faktin se **i Padituri A. mbetet edhe pronar i truallit** mbi të cilin është ndërtuar ky objekt.

Përfundimisht, Gjykata vlerëson se, në bazë të nenit 24/1 të Ligjit nr. 10192 datë 03/12/2009, pjesa e pasurisë që sipas ekspertimit vlerësues përcaktohet si vijon:

Kati përdhes Restorant 511m²; Kati i I-rë;II-të;III-të dhe i IV-rt me nga 366 m² secili si dhe kati i V-stë papafingo me 321 m², të ndodhura në objektin “Bar- Restorant- Hotel”, në lagjen 13 Plazh Durrës, duhet të konfiskohen e të kalojnë në favor të shtetit sepse pala që e pretendon këtë pasuri, duke qënë subjekt i ligjit parandalues, nuk e justifikoi ligjshmërinë e të ardhurave të investuara për ndërtimin e saj.

Në bazë të nenit 28 të ligjit 10 192 datë 03,12,2009, ky vendim duhet të ekzekutohet menjëherë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, duke u mbështetur në nenet 3, 7, 10, 20, 21,22, 23, 24, 25, 26 e 28-38 e vijues, të Ligjit nr.10192 date 03/12/2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë” dhe nenit 305-306 të Kodit të Procedurs Civile;

VENDOSI

1. Pranimin e kërkesës. Konfiskimin e pasurisë “xxx-xxxxxx-xxxxx”, me x+x/x kate ku përfshihet: Kati përdhes “xxxx-xxxxxx” me sipërfaqje xxxmx; Kati i x-rë;xx-të;xxx-të dhe i xxxxx-rt me sipërfaqje prej xxx mx secili kat, si dhe Kati i xxxxx-stë, papafingo e papërfunduar, me sipërfaqje xxx mx; **sipërfaqe totale ndërtimi e konfiskuar është xxxx mx.**

Objekti i konfiskuar është në gjendje pune si”xxx-xxxxxx-xxxxx” dhe konfiskohet së bashku me të gjitha pajisjet dhe aksesorët që ndodhen në mjediset e konfiskuara.

Pasuria e konfiskuar, ndodhet e ndërtuar në pronën e të Paditurit A. H. , në truallin me sipërfaqe xxx mx, në zonën kadastrale nr. xxxx, në lagjen nr. xx, Plazh, Durrës.

2 Pjesa e pasurisë “xxxxxx-xxxx” me sipërfaqje xxx, që gjendet në katin(-1), përjashtohet nga konfiskimi dhe mbetet pronë e të Paditurit A. H. .

3 Për administrimin dhe përdorimin e kësaj pasurie të paluajtshme të ngarkohet z. G. L. , Administrator pranë Agjencisë për Administrimin e

Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, ndërsa për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohen Zyra e Përmbartimit e Rrethit Durrës.

4 Shpenzimet procedurale në fazën e hetimit pasuror i ngarkohet të paditurit A. H. ndërsa shpenzimet në fazën e hetimit gjyqësor duke shtuar edhe vlerën prej 162 000(njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) të ekspertimeve të kryera, i ngarkohen solidarisht të Paditurit A. H. dhe Ndërhyrësit Kryesor S. A. .

5 Urdhërohet Kryesekretaria të dërgojë këtë vendim për ekzekutimi të menjëherëshëm.

Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda brenda afatit ligjor.

Seanca gjyqësore deklarohet e mbyllur.

Tiranë, sot me **date 18.11.2011, ora 15.45.**

SEKRETARE

GJYQTAR

ERMIRA TERBUNI

GURALI BRAHIMLLARI